



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Financave
Drejtoria e Pergjithshme Dogana

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Brendshme
Drejtoria e Pergjithshme e Policise

URDHER

Nr. 243/1 Prot., date 12.01.2009

Procedurat e perbashketa te Policise Kufitare dhe Migracionit dhe Sherbimit Doganor Shqiptar ne PKK Qafe Thane dhe Kakavije.

Bazuar ne Ligjin Nr. 9746, date 04.06.2007, "Per Policine e Shtetit", ne Ligjin NR. 8499, date 27.01.1999, "Kodi Doganor ne RSH", ne Ligjin Nr. 9861, date 24.01.2008 "Per Kontrollin dhe mbikqyrjen e Kufirit Shteteror", ne Rregulloren e Perbashket te Ministrit te Brendshem Nr. 796/6, date 09.04.2008 dhe Ministrit te Financave Nr.4873/1, date 17.06.2008 "Per bashkepunimin ndermjet Sherbimit Doganor dhe Policise se Shtetit", me qellim rritjen e performaces se dy sherbimeve dhe lehtesimin e procedurave te hyrje/ daljeve te shtetasve dhe mjeteve shqiptare dhe te huaja;

Ushtrimin e kontroleve te perbashketa te Policise Kufitare dhe Migracionit dhe Sherbimit Doganor Shqiptar, per zbatimin ne praktike te parimit "nje ndalese nje kontroll" ne PKK Qafe Thane dhe Kakavije.

A.Per kontrollin e udhetareve

Shtetasit shqiptare ose te huaj qe hyjne ose dalin ne ose nga Republika e Shqiperise perpunohen ne terminalin e pasagjereve dhe i nenshtrohen kontrollit kufitar/doganor te njekohshem. Policia Kufitare dhe migracionit kontrollon per dokumentet e udhetimit, vizen e hyrjes (kur nevojitet) dhe qellimin e udhetimit. Sherbimi Doganor per kontrollin e bagazheve. Ushtrohet cdo lloj kontrolli tjeter ne baze te Analizes se Riskut, informacionit dhe perzgjedhjes:

1.Kontrolli minimal i personave;

Kur shtetasi shqiptar/ i huaj afrohet ne kabinen e kontrollit paraqet dokumentin e udhetimit te vlefshem per te udhetuar. Kontrollori i Policise Kufitare dhe Migracionit se bashku me punonjesin e doganes bejne kontrollin minimal.verifikimi konsiston ne :

- a)Kqyrjen e dokumentit te udhetimit per rregullsine e tij behet duke u bazuar ne procedurat e brendshme te Policise Kufitare dhe migracionit.
- b)Punonjesi i doganes ben kontrollin e bagazheve nese gjykohen per kontroll te tvre.
- c)Punonjesi i Policise Kufitare dhe Migracionit ben regjistrimin e personit ne sistem.
- d) Shtetasve te huaj i behet verifikim i shpejte i diteve te qendrimit(ne dalje)
- e)Gjate regjistrimit ben kujdes per te lexuar alarmet qe jep sistemi.
- f)Pas veprimeve te mesiperme vulos pasaporten dhe lejon shtetasin te hyje/ dale ne/ nga Republika e Shqiperise.
- g)Kur personi i paraqitur ne kabine rezulton se nuk permbush kushtet e daljes ose te hyrjes, kontrollori shqiptar refuzon hyrjen / daljen ne/ nga Republika e Shqiperise duke bere evidentimin perkates ne sistem si dhe duke plotesuar formularin e parashikuar me kete rast.

2. Kontrolli i detajuar i personave;

Kur gjate kontrollit minimal, kontrollori i PKM ose punonjesi i doganes gjykojne se per kete person duhet ushtruar kontrolli i detajuar kryejne veprimet e meposhtme;

a) Kontrollori i PKM njofton Pergjegjesin e Turnit dhe merr masa per sigurimin e tij, dergon pasaporten per ekzaminim te metejshe ne laborator. Pas verifikimit ne laborator vazhdohet procedura ne baze te rezultatit te verifikimit.

b) Kur nga sistemi jepet mesazhi per "person ne kerkim", kontrollori njofton Pergjegjesin e Turnit dhe vepron ne baze te urdhrat te tij per sigurimin e personit dhe hartimin e akteve procedurale per kete rast.

c) Kur gjate regjishimit ne sistem del mesazhi per pasaporten e pavlefshme, te humbur", "jashte perdorimit" kontrollori njofton pergjegjesin e turnit dhe harton procesverbalin e bllokimit te pasaportes.

d) Kur gjate evidentimit te te dhenave ne hyrje/ dalje, shtetasit i refuzohet ajo, kontrollori e prapeson, ben ev identimin ne sistem dhe perpilon procesverbalin e prapesimit/ refuzimit.

e) Kur nga punonjesi PKM ose i doganes kerkohet qe personi te shkoje ne ambientet e posacme per kontroll te detajuar, duhet te kete parasysh gjinine e personit qe kontrollohet.

f) Kur udhetaret jane ne grup me autobus, ne baze te gjykimit, me informacion ose perzgjedhje, pasagjeret perpunohen ne terminal duke i kaluar nje e nga nje ne kontrollin e PKM dhe doganes. Pas perfundimit te kontrollit u jepet pasaporta , lejohen te hipin ne autobus per te vazhduar udhetimin.

B. Per kontrollin e autoveturave.

Automjetet shqiptare dhe te huaja qe hyjne/ dalin nga Republika e Shqiperise i nenshtroben nje kontrolli minimal, kontrolli te detajuar dhe cdo lloj kontrolli tjeter ne baze te Analizes se Riskut, informacionit dhe perzgjedhjes. Kontrolli ushtrohet i njekohshem nga Policia Kufitare dhe Migracionit dhe Dogana.

1. Kontrollin minimal i autovetures

Kur nje automjet parayitet per te hyre ose dale ne ose nga vendi yne, kontrollori Policise Kufitare dhe Migracionit dhe punonjesi i Doganes, bejne veprimet si ne procedurat per kontrollin minimal te personit duke;

a) Kontrollojne ne menyre vizuale autoveturen

b) Kerkojne nga drejtuesi te hape bagazhin e mjetit

c) Nese nuk ka probleme e lejojne te vazhdoje udhetimin.

2. Kontroll te detajuar i autovetures.

Nese gjate kontrollit minimal ka dyshime, informacion dhe bazuar ne analizen e riskut kryhet kontrolli i detajuar. Grupi i perbashket kryen keto veprime;

a. I kerkojne drejtuesit te mjetit te drejtoje makinen ne ambientin e Ures se Kontrollit te Mjeteve duke e shoqeruar me nje punonjes policie.

b. Bejne kontrollin e detajuar te mjetit duke perdorur pajisjet e dhene ne perdorim.

c. Ne kontrollin e detajuar perdoret qeni antidroge dhe mjetet e tjera ne perdorim te te dyja agjencive.

d. Ne perfundim te kontrollit hartojne aktet procedurale ne baze te rezultatit te kontrollit.

e. Evidentojne ne regjister kontrollin e bere.

2. Kur gjate kontrollit evidentohen mallra te ndaluara, lende narkotike, toksike dhe psikotrope, veprimet kryhen ne baze te Kodit te Procedures Penale ose te Kodit Doganor.

C. Per kontrollin e autobuseve

Autobuset shqiptare dhe te huaj qe hyjne/ dalin nga Republika e Shqiperise i nenshtrohen nje kontrolli minimal, kontrolli te detajuar dhe cdo lloj kontrolli tjeter ne baze te Analizes se

Riskut, informacionit dhe perzgjedhjes. Kontrolli ushtrohet i njekohshem nga Policia Kufitare dhe i Migracionit dhe Dogana. Policia Kufitare dhe Migracionit kontrollojnë pasagjeret per dokumentet e udhetimit, vizen e hvrjes (kur nevojitet) dhe qellimin e udhetimit. Sherbimi Doganor kontrollojnë bagazhet dhe mjetin. Gjithashtu ushtrohet cdo lloj kontrolli ne baze te Analizes se Riskut, informacionit dhe perzgjedhjes:

1. Kontrolli minimal behet duke kaluar pasagjeret ne terminal.
 - a. Kontrollohet dokumentacioni dhe bagazhet e tyre ne te njejten kohe.
 - b. Pas mbarimit te kontrollit pasagjeret hipin ne autobus dhe vazhdojne udhetimin.

2. Kontrolli i detajuar behet ne ambientin e posacem te ngritur per kontroll.
 - a. Drejtuesi i mjetit qendron bashke me mjetin ndersa pasagjeret qendrojne ne terminal.
 - b. Grupi yne ben kontrollin e detajuar i cili perbehet nga nje punonjes i PKM dhe nje i doganes.
 - c. Ne kontrollin e detajuar perdoret dhe qeni antidroge dhe mjetet e tjera ne perdorim te te dyja agjencive.
 - d. Ne perfundim te kontrollit hartohen aktet procedurale ne baze terezultatit te kontrollit.
 - e. Evidentojne ne regjister kontrollin e bere.
 - f. Kur gjate kontrollit evidentohen mallra kontrabande, te ndaluara, lende narkotike, toksike dhe psikotrope, veprimet kryhen ne baze te Kodit te Procedures Penale ose te Kodit Doganor.

D. Per kontrollin e kamioneve

Kamionet shqiptare dhe te huaj qe hyjne/ dalin nga Republika e Shqiperise i nenshtrohen nje kontrolli minimal, kontrolli te detajuar dhe do lloj kontrolli tjeter ne baze te Analizes se Riskut, informacionit dhe perzgjedhjes. Kontrolli ushtrohet njekohshem nga Policia Kufitare dhe Migracionit dhe Dogana bazuar ne baze te Analizes se Riskut, informacionit dhe perzgjedhjes:

1. Kontrolli minimal behet ne korsine e kamioneve prane kabines se regjistrimit;
 - a. Kontrollohet dokumentacioni i drejtuesve dhe mjetit nga PKM dhe dogana sipas drejtimit te punes.
 - b. Behet kontroll i siperfaqshem i mjetit.
 - c. Kur cdo gje rezulton ne rregull lejohet te vazhdoje udhetimin.
2. Kontrolli i detajuar behet ne ambientin e posacem te ngritur per kontroll.
 - a. Drejtuesi i mjetit bashke me mjetin dergohet ne kontrollin e detajuar ndersa shoqeruesit (nese ka) mjetin qendrojne ne terminal.
 - b. Crupi qe ben kontrollin e detajuar perbehet nga nje punonjes i PKM dhe nje i doganes.
 - c. Ne kontrollin e detajuar perdoret dhe qeni antidroge dhe mjetet e tjera ne perdorim te te dyja agjencive.
 - d. Ne perfundim te kontrollit hartohen aktet procedurale ne baze terezultatit te kontrollit.
 - e. Evidentojne ne regjister kontrollin e bere.
 - f. Kur gjate kontrollit evidentohen mallra te ndaluara, Lende narkotike, toksike dhe psikotrope, veprimet kryhen ne baze te Kodit te Procedures Penale ose te Kodit Doganor.

Keto procedura jane te detyrueshme per tu zbatuar nga punonjesit e te dyja agjencive qe operojne ne keto PKK.

E. Per kontrollet e perbashketa te detajuara raportohet ne qender sipas linjave cdo 24 ore sipas formularit bashkelidhur ketij urdhri.

F. Per zbatimin e ketyre procedurave ngarkohen Stacionet e Policise Kufitare dhe Migracionit dhe Deget Doganore Qafe Thane dhe Kakavije.

G. Per marrjen e masave organizative per zbatimin ne praktike te ketyre procedurave, ngarkohen Drejtoria e Sherbimeve Operacionale ne Departamentin per Kufirin dhe Migracionin ne DPP dhe Departamenti Teknik ne DPD.

H. Per kontrollin e zbatimit te ketij urdhri ngarkohen Departamenti Operativ Hetimor ne DPD dhe Departamenti per Kufirin dhe Migracionin ne DPP.

I. Ky urdher hyn ne fuyi me date _ . 2009.

Perparim DERVISH!

DREJTORI I PERGJITHSHEM I DOGANAVE